

Nr. Prot. 2424  
20.8.2018

Subjekti "Moreno Morellato"  
Autost.Dr-Tr km 10  
Xhafzotaj-Durres

Nr. 161 prot

Tirane me 10/8/2018

Lenda: Informacion per pjesmarrjen e publikut ne konsultim mbi aktivitetin e subjektit fizik  
Moreno Morellato ne lidhje me aplikimin per Leje Mjedisit Tipit B

Per: Agjensine Kombetare te Mjedisit Tirane

Ky informacion mbi aktivitetin e subjektit fizik **Moreno Morellato** I drejtohet Agjensise Kombetare te Mjedisit ( AKM) ne perputhje me VKM nr.419 dt25.06 2014 kreun IV " Per Informimin dhe pjesmarrjen e publikut per aplikimin per leje mjedisit Tipit A dhe B.

### 1. Te dhenat per subjektin:

Subjekti fizik me emerin tregtare "**Moreno Morellato**" me administrator z.**Moreno Morellato** eshte themeluar dhe regjistruar si person fizik me dt 24.05.2018 ne QKB, me objektin e aktivitetit "**prodhim, montim I anijeve dhe varkave turistike dhe mjeteve te tjera lundruese.** etj. Kapitali I subjektit perbehet nga vete kapitali I administrator.Subjekti eshte i paisur me numer indentikues **NIPT L81724504R.**

### 2. Aplikimi per lejen e mjedisit.

Per ushtrimin e aktivitetit subjekti fizik, kerkon te paiset me **Leje Mjedisit Tipit B**, referuar ligjit nr. 60/2014, Per-nje ndryshim te ligjit nr.10448 dt 14.07.2011" Per lejet e mjedisit te ndryshuar" bashkelidhur shtojca 1 " Lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi , aktivitet te cilin e shikojme te klasifikohet sipas kesaj shtojce ne pozicionin ID. 10.3ne veprimtarine "**Prodhim I mjeteve te tjera te transportit n.q se nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce.** Kapaciteti kufi per lejet e tipit B , te gjitha instalimet

### 3. Vendodhja e aktivitetit I shoqerise.

Aktiviteti I subjektit fizik **Moreno Morellato** zhvillohet ne nje object me nr. pasurie 346/56 ne pronesi te nje subjekti juridik **Verdigo** shpk sipas kontrates se qirase te lidhur me dt 07.06.2018 me nr.1077 rep dhe nr.648/1 kol. Objekti ka nje siperfaqe ndertimi 4478 m2 e ndodhur ne zonen kadastrale me nr.3852 nga siperfaqja totale e ndertimit te kaponit rreth

2239 m<sup>2</sup> subjekti fizik **Moreno Morellato** mer ne perdorim me nje afat 5 vjecar me te drejte rinovimi. Objekti ndodhet parne autostrates Durres Tirane km 10 ne Xhafzotaj te Njesine Administrative Rrashbull pjese e bashkise Durres

#### 4. Pershkrimi I aktivitetit

Subjekti fizik **Moreno Morellato** sic theksuam me spe zhvillohet ne nje kapanon me nje siperfaqe 2239 m<sup>2</sup> me nje lartesi 7-8 m ne pronesi te shoqerise Verdigo shpk. Ne kete subject jane te punesuar 6 punonjes.

Subjekti **Moreno Morellato** duke marre kerkesat e klienteve dhe nevojat e subjekteve te ndryshem harton planin e prodhimit te varkave turistike lundruese gjate muajit . Ne baze te kerkesave pergatitet forma e mjetit lundrues me nje material rreshire e cila ka nje rrezistence te larte.

Ne pergatitjen e varkave turistike si dhe mjeteve te tjera lundruese perdoren material si tekstil me fije qelqi dhe rreshire ( vetroresine), material te pa perpunuara te ftohte plastike te perbere pa presion me karakteristika me rezistence te konsiderueshme.

Pergatitja e mjeteve lundruese kryen ne keto procese perpunuese;

1. Lubrifikimi I formes se mjetit qe do te pergatitet, proces qe kryet me nje dyll te vecante I cili kryet ne menyre manual shtate here.
2. Gelgotatura e formes eshte kryer me dore e cila formon pjesen e dukshme te artefakteve.
3. Prerja e fibrave te qelqit sipas mases se produktit
4. Pozicionimi I fibrave te qelqit te cilat I japin elasticitet produktit te perfunduar dhe procesit te lageshtise.  
Rreshira eshte nje material qe percakton formen e perhershme te produktiti dhe ka nje rrezistence te larte ndaj ngarkesave te thyerjes dhe te terheqjes.
5. Me perfundimin e procesit te tharjes te materialit fillon procesi I shkeputjes se produktit nga forma.

#### Permbledhje jo teknike e instalimit

Ne lidhje me aktivitetin e subjektit fizik **Moreno Morellato** theksojme se aktiviteti eshte nje instalim ekzistues, nuk kemi te bejme me nje instalim te ri dhe per rrjedhoje nuk kemi te bejme me nje permbledhje te raportiti te vleresimit te ndikimit ne mjedis .

#### 5. Konsultime nderkufitare kur kerkohet sipas legjislacionit ne kufi

Lidhur me kete pike te informacionit te aktivitetit te subjektit fizik **Moreno Morellato** theksojme se aktiviteti i subjekti nuk zhvillohet ne nje zone kufitare dhe per rrjedhoje nuk kemi te bejme me nje pjesmarrje te publikut ne konsultime nderkufitare per aktivitetin e subjektit.

**6. Autoriteti Vendimarrës për dhenien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit si dhe procedurat dhe afatet që do të ndiqen.**

Mbeshtetur në ligjin Nr.10448 dt 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar si ligjith 60/2014, Autoriteti ku aplikohet dhe leshohet Leja e mjedisit e Tipit A, B dhe C është Qendra Kombëtare e Biznesit

Ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti, i cili ndjek procedura dhe afatet e miratimit të Lejes së Mjedisit Tipit A dhe B. të percaktuara këtu në VKM nr.419 dt 25.06 .2014

**7. Adresa.**

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) Rr. Sami Frasheri Nr.4 Tirane**

Tel & fax 042 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al), e-mail: [info@akm.gov.al](mailto:info@akm.gov.al)

Subjekti  
**Moreno Morellato**





OKB

